



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**  
**Nr.177, datë 19.2.2009**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT**  
**“SHKOLLA E LARTË PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” do të organizohet në tri fakultete:

a) Në Fakultetin e Shkencave Politike, me program studimi në “Shkenca politike”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

b) Në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, me program studimi në “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

c) Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, me program studimi në “Ekonomi”, në formën e studimeve me kohë të plotë.

3. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” do të ofrojë programe studimi, të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 vite dhe në mbarim të tyre do të lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), përkatësisht, në:

a) Shkenca politike;

b) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;

c) Ekonomi.

4. Ngarkohet “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik huaj, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialiteteve.

5. “Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. “Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

